

UDHËRRËFYES

PËR AUTORITETET PUBLIKE MBI PROJEKT AKTET QË KANË TË BËJNË ME TË DHËNAT PERSONALE



PËRSE ËSHTË I RËNDËSISHËM DËRGIMI I NJË PROJEKTAKTI PËR MENDIM

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Adresa: “Rr. Kavajës, Nd. 80, H. 1, Kati 5, Tiranë

Telefoni: +35542237200

E-maili: info@idp.al

Website: www.idp.al

Tiranë 2014



Ky udhërrëfyes ndihmon për një zbatim sa më korrekt të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë ushtrimit të funksioneve nga autoritetet publike, me vëmendje të veçantë në dërgimin për mendim pranë Komisionerit të projektakteve ligjore, nënligjore dhe projekteve që kanë të bëjnë me të dhënat personale, përpara miratimit të tyre.

❖ **Detyrimi i institucioneve për të paraqitur projektakte ligjore e nënligjore dhe projekte pranë KMDP-së sipas parashikimeve të Nenit 31/1/a.**

✚ **Fillimisht njihuni shkurtimisht me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale**

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar ka dhënë tre zgjidhje të rëndësishme në kuadër të mbrojtjes së privatësisë, si një e drejtë themelore e mbrojtur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 35 të saj.

1. Ai ka vendosur rregulla që duhet të zbatohen nga të gjithë institucionet dhe organet shtetërore dhe private që përpunojnë të dhëna personale;
2. i jep të drejtë subjekteve të të dhënave që të zbulojnë se çfarë po ndodh me të dhënat e tyre personale dhe të kërkojnë ndreqjen nëse shkelen kërkesat e ligjit mbi përpunimin e tyre;
3. krijon një institucion të pavarur, KMDP- në, dhe i jep mjete dhe kompetenca të sigurojë zbatimin e rregullave të detyrueshme për **përpunimin e të dhënave personale** të individëve nga të gjithë **institucionet publike** dhe private/**kontrolluesit**.

Ligji lidhet drejtpërdrejtë me fusha të rëndësishme të së drejtës. Pajisjet e teknologjisë bashkëkohore, kompjuterat, interneti, incizime audio dhe video etj, janë aktualisht ndër mjetet kryesore të përpunimit të të dhënave.

Kjo e bën akoma më problematik dhe gjithëpërfshirës procesin e përpunimit të të dhënave personale, çfarë shton edhe rëndësinë e harmonizimit të koordinuar të legjislacionit kombëtar me parimet e parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pika 3 evidenton disa nocione të rëndësishme. Udhërrëfyesi jep detaje mbi kuptimin e tyre. Konsiderojini në punën tuaj por edhe në hartimin e projektakteve, për të kuptuar nëse ju duhet të harmonizoni p/aktin me ligjin takues të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit reflekton në harmonizimin e tij por pas rolit tuaj aktiv, dërgimit për mendim.

➤ **Përse është i rëndësishëm dërgimi i projektakteve ligjore e nënligjore për mendim?**

✚ **Përputhshmëria me aktet ndërkombëtare.**

Konventa Nr 108 e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale dhe Protokollin Shtesë i saj”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin



9288, datë 07/10/2004, Direktivat e 2002/58/EC dhe 95/46/ EC të BE-së bëjnë përcaktimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale.

 Zbatueshmëria e nenit 31/1/a të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

E konsiderojmë bashkëpunim rolin tonë në përmbushjen e kësaj dispozite, sepse ligji na prek e na mbron të gjithëve, kur e hartojmë në harmoni me aktet takuese dhe në të kundërt na cënon.

Çfarë parashikon shprehimisht Neni 31, pika 1/a?

1.Komisioneri është përgjegjës për: a) dhënien e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

- Si do të mund ta ushtrojmë ne këtë përgjegjësi?
 - Në bashkëpunim me ju.
- Po cilët jeni ju në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale?

Shkurt dhe saktë quheni “Kontrollues”. Term i përdorur gjerësisht kudo, tanimë edhe në këtë udhërrëfyes.

Cili quhet Kontrollues?

“Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj”.

Nga veprimtaria e punës së Komisionerit është vënë re se ka një mungesë harmonizimi të legjislacionit kombëtar me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo edhe për shkak se Ligji nr.9887, date 10.03.2008 është një ligj relativisht i ri dhe i gjithë legjislacioni i miratuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji është bërë pa marrë parasysh parashikimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duke penguar punën e institucioneve përkatëse por, mbi të gjitha, duke rrezikuar një të drejtë themelore kushtetuese të subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e jetës private.

Vazhdimisht hasni termin përpunim. Çfarë do të thotë kjo për ju?

“Përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash”.



Çfarë janë të dhënat personale?

“Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social”.

Të tillë elementë mund të jenë: Emri, mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, arsimi, profesioni, titulli shkencor, kombësia, shtetësia, etj. Shembuj të tjerë përfshijnë: informacione për klientë individual, e-mail, fotografitë e individëve, regjistrime të telefonave informacione për llogaritë bankare të personave apo për policat e tyre të sigurimit, databazat, etj.

Rrjetet dixhitale kanë kapacitet të lartë dhe mundësi për përpunimin e të dhënave personale. Zhvillimi i suksesshëm i kalimit të kufijve nga këto shërbime është pjesërisht i varur nga besimi i përdoruesve se privatësia e tyre nuk do të jetë në rrezik.

Interneti ka marrë një përdorim të gjerë në shërbimet dhe komunikimet elektronike. Përdorimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike hap mundësi të reja për përdoruesit por, gjithashtu dhe risqe të reja për të dhënat e tyre personale dhe privatësinë.

Dhënia e mendimit të Komisionerit është e rëndësishme.

Për shembull; Përpunimi i të dhënave personale me pëlqim.

Ligji përcakton pëlqimin si një nga parimet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale. Metodatat e marrjes së pëlqimit dhe nëse pëlqimi duhet marrë ose jo, nëse përbën element të mjaftueshëm për të legjitimuar përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale ndryshojnë rast pas rasti. Të gjitha këto alternativa, bëjnë të domosdoshëm një trajtim të duhur të procedurave të marrjes së pëlqimit dhe vlefshmërisë së tij.

Në rast se parashikime të gabuara bëhen në akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në lidhje me pëlqimin, kjo do të sjellë pamundësinë e zbatimit në praktik të tyre, mos harmonizim legjislativ.



- **Cilët janë autoritetet publike zbatues të nenit 31/1/a të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar?**

Autoritet publik në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale janë të gjithë institucionet e administratës qendrore e vendore si; Ministrinë dhe organet e varësisë, entet publike, njësitë e pushtetit vendor, etj.

Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe të gjithë kontrolluesit, autoritete publike që konstatojnë që në aktet që prodhojnë ka elementë të përpunimit të të dhënave personale duhet të respektojnë këtë dispozitë ligjore.

- **Cilat janë veprimet që duhen ndërmarrë nga këto autoritete për marrjen e mendimit nga Komisioneri në kuadër të nenit 31/1/a të mbrojtjes së të dhënave personale?**

Si fillësë vlerësoni nëse projekt/akti do të ketë pritshmëri përpunimin e të dhënave personale apo ndër të tjera edhe përpunimin e të dhënave personale.

Do të përhapen të dhënat?

“Përhapje” është komunikimi i informacionit për të dhënat personale palëve të papërcaktuara, në çfarëdo forme, edhe përmes vënies në dispozicion ose konsultimit.

Do të transmetohen ato?

“Transmetim” është transferimi i të dhënave personale të marrësit”.

Do të transferohen ato diku jashtë vendit?

“Transferim ndërkombëtar” është dhënia e të dhënave personale marrësve në shtetet e huaja”.

Do të aksesohen ato? Ku dhe si?

Ky vlerësim ju ndihmon për të kuptuar nëse duhet të drejtoheni Zyrës së Komisionerit për mendim.

Të gjitha parashikimeve të hartuara nga ju në draft, **si propozues të iniciativave ligjore**, Komisioneri i përgjigjet në kohë me dakortësi apo rekomandime për shtesa e ndryshime të tjera në përputhje me fushën që mbulon.



Komunikimi me Komisionerin, madje edhe përpara hartimit të projekt/aktit të dërguar për mendim, ju jep mundësinë e njohjes me të tjera detyrime të rëndësishme.

p.sh Ju duhet të depozitoni Njoftimin pranë zyrës së Komisionerit.

Gjendet një formular që duhet plotësuar në mënyrën e zgjedhur nga ju/manualisht apo edhe online.

Për më shumë klikoni në www.idp.al në rubrikën “Regjistrimi”

Shmangia sjell sanksione

Njoftimi lidhet edhe me projektaktet që po hartoni, pasi nëse pas miratimit të tij do të nisë një përpunim i të dhënave atëherë ju edhe këtë përpunim të ri duhet ta adresoni pranë Komisionerit pavarësisht se keni njoftuar më parë.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale kërkon caktimin e një personi të stafit tuaj që kryesisht në veprimtarinë e punës së tij të merret me trajtimin e përpunimit të të dhënave personale.

E keni përmbushur këtë kërkesë?

Para çdo ndërmarrje klikoni edhe faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al

Gjithashtu, shkruani në adresën info.idp.al